REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 85 prot. Kamëz, më 21.0.2026

V E N D I M
Nr. 74 .Datë 21/9 2026
MBI

"DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJE NË NEVOJË NGA BUXHETI I BASHKISË"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.09.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.68 Datë 18.09.2026 në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr. 57, datë 18/07/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime" në VKM nr. 597 datë 04.09.2019, Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 90 dt. 17.12.2025 "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2026"; **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit e të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike me një fond prej **45.000 (dyzet e pesë mijë)** lekë për muajin **Shtator** 2026. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.

2. Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike për familjen si më poshtë.

a) **Elton Emri Neza** me vlerën **45,000** lekë si një rast i veçantë për përballimin e shpenzimeve për studimet e tij.

3. Bashkëlidhur ju paraqesim relacionin shpjegues.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI